



UNECE



Austrian
Development
Agency



Seminar – Prezantimi mbi kornizën e modelimit ndërmjet Klimës-Tokës-Energjisë-Ujit dhe përdorimit të saj në vlerësimin e nexus-it në basenin lumor të Drinit

6 korrik 2021, 9:30–13:00 (Kufiri kohor i EJGL)

7 korrik 2021, 9:30–13:00 (Kufiri kohor i EJGL) – vetëm për ekspertët

Do të organizohet online në platformën zoom

Linku për tu lidhur: <https://us02ëeb.zoom.us/meeting/register/tZlSf-vrz0rHNCG9ËGJtmËl0TqZGeuLhGe>

Në kuadër të projektit

“Promovimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në Europën Juglindore, nëpërmjet përdorimit të qasjes nexus”

Zbatuar nga Partneriteti Global i Ujit për Mesdheun, në bashkpunim me Komisionin Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën

Do të mundësohet përkthimi i drejtpërdrejtë ndërmjet gjuhës angleze, shqipe dhe maqedonase

Koncept

Korniza e modelimit mbi "Klimë-Tokë-Energji-Ujë" është një instrument për analizën sasiore të lidhjes (nexus) midis sistemeve biofizike të klimës, tokës (përfshirë bujqësinë), energjisë dhe ujit. Ajo është zhvilluar në dekadën e shkuar nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (IAEA), Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështje Ekonomike dhe Sociale (UNDESA), Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), KTH dhe shumë partnerë të tjerë. Është përdorur kryesisht për të mbështetur hartimin e paketave të politikave ndërsektoriale kombëtare dhe rajonale për adaptimin dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Në kuadër të vlerësimit të lidhjes (nexusit) përgjatë të Pellgut të Lumit Drin, instrumenti mbi modelimin fokusuar në energjinë dhe ujin është përdorur për të përcaktuar nga ana sasiore përfitimet nga bashkpunimi ndërkufitar në menxhimin e kaskadës së hidrocentraleve në kushte të ndryshme. Këto kushte përfshijnë për shembull ndryshimin e rregullave të përdorimit të kaskadës (hidrocentralit) për të patur kushte më të mira për kontrollin ndaj përmbajtjeve.

Ky seminar i adresohet eksperteve dhe zyrtareve nga institucionet që lidhen me energjinë (Ministritë, ndermarrjet, agjencite rregullatore) ose autoritetet e baseneve lumore përgjate Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë se veriut me një interes në angazhimin e analizave të modelimeve. Preferohen, pjesëmarrës që kanë njohuri bazike mbi ndërlidhjen që egziston ndërmjet ujit, energjisë, ushqimit dhe ekosistemeve dhe që janë të lidhura me vlerësimin përgjatë basenit lumor të Drinit. Qëllimi kryesor i seminarit është për ti familjarizuar pjesëmarrësit me kuadrin e modelimit (CLEËs). Pjesëmarrësit do të marrin njohuri themelore rreth këtij kuadri dhe aplikimit global të tij, gjithashtu do fitojnë experencë praktike të përdorimit të tij, në kontekstin e vlerësimit të basenit lumor të Drinit.

Ky seminar është strukturuar në dy dite. Dita e pare ka për qëllim pjesëmarrjen nga një audiencë e gjerë. Pjesëmarrësit do të marrin një prezantim të metodologjive ekzistuese të vlerësimit të nexus dhe kornizës së modelimit. Ata më pas do të diskutojnë në grup sfidat aktuale dhe potenciale të lidhjes së energjisë me ujin përgjatë pellgut të lumit Drin dhe më pas do të vlerësojnë cilësinë e punës së modelimit të kryer me instrumentin modelues në kuadër të vlerësimit të nexus përgjatë pellgut të lumit Drin. Për një ndërveprim me moderatorët përgjatë dhomave dhe për të arritur rezultate më të mira, rekomandohen deri në 30-35 pjesëmarrës.

Në ditën e dytë priten të pëfshihen një numër më i kufizuar (max 15 persona me qëllim për të lejuar moderatorët të ndjekin co pjesëmarrës individualisht) me eksperiencë bazike në modelim dhe interes në zhvillimin e aftësive, për identifikuar nga institucionet e tyre respective.

Formati: Seminari do të mbahet virtualisht përmes platformës Zoom.

Linku për tu rregjistruar dhe për tu lidhur në takim është

<https://us02ëeb.zoom.us/meeting/register/tZIsf-mvrz0rHNCG9ËGJtmËl0TqZGeuLhGe>.

Linku i lidhjes për ditën e dytë të seminarit do të ndahet ndërmjet ekspertëve të përzgjedhur.

Do të mundësohet përkthimi i drejtpërdrejtë ndërmjet gjuhës angleze, shqipe dhe maqedonase

Para seminarit: Nuk kërkohet instalimi i softuerit.

Agjenda

Dita 1: 6 Korrik (Përmbledhje mbi metodologjitë dhe modelet)

- 9:30 Mirëseardhja dhe prezantimi (Z. Tassos Krommydas, Zyrtar i lartë programi, GWP-Med, Dr. Francesco Gardumi, KTH Royal Institute of Technology)
- 9:45 Prezantimi i metodologjisë mbi vlerësimin e nexusit dhe instrumentit CLEWs (Dr. Francesco Gardumi, KTH Royal Institute of Technology)
- 10:30 Pushim
- 10:45 Diskutimi mbi situatën aktuale edhe atë potenciale të nexusit ndërmjet ujit-energjisë dhe bujqësisë përgjatë basenit të Drinit (Udhëhequr nga Dr. Francesco Gardumi, KTH Royal Institute of Technology)
- 11:15 Prezantimi i modelit të energjisë dhe ujit në vendet kufitare të basenit të lumit të Drinit-duke nënvizuar kornizën e modelimit (OSeMOSYS) (Z. Youssef Almulla, KTH Royal Institute of Technology, TBC)
- 12:00 Ndarje në grupe: Diskutim (udhehequr nga trajneret e KTH) mbi skenarët, rezultatet e përzgjedhura dhe aspektet metodologjike mbi modelimin uji-energji përgjatë basenit të Drinit (All)
- 12:45 Fundi i ditës së parë

Dita 2: 7 korrik (Sesioni teknik mbi modelimin)

- 9:30 Mirëseardhja dhe përmbledhje e dites së parë (Dr. Francesco Gardumi, KTH Royal Institute of Technology)
- 9:45 Ushtrim: Krijimi i një sistemi modeli të thjeshtë nëpërmjet një sistemi të hapur modeli (Udhëhequr nga Dr. Francesco Gardumi, KTH Royal Institute of Technology)
- 10:45 Pushim
- 11:00 Ushtrim: Modifikimi dhe punimi mbi një model egzistues duke përdorur "Jupyter notebook" (Udhëhequr nga Dr. Francesco Gardumi, KTH Royal Institute of Technology)
- 11:45 Github dhe transferimi i modelit: Detaje mbi modelin e ujit dhe energjisë mbi basenit e Drinit dhe vendeve kufitare – si duket, si punon, si mund të përdoret dhe vendosja në përdorim duke përdorur "Jupyter notebook" (Z. Youssef Almulla, KTH Royal Institute of Technology)
- 12:30 Fundi i ditës së dytë (Z. Youssef Almulla, KTH Royal Institute of Technology)